LIGJ
Nr.7734, datë 20.7.1993

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7676, DATË 2.3.1993 "PËR TATIMIN MBI QARKULLIMIN"

Në mbështetje të neneve 13.dhe 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7676, datë 2.3.1993 "Për tatimin mbi qarkullimin" pas paragrafit të parafundit të nenit 3 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Importimin e produkteve të konsumit ushqimor bazë të mëposhtme
-Vezë
-Nënproduktet e qumështit
-Vaj ushqimor
-Sheqer
-Makarona
-Mish
-Oriz
-Ushqimet që shërbejnë për blegtorinë dhe shpendët".

Neni 2

Përjashtohen nga tatimi mbi qarkullimin vlera e shërbimit në të gjitha shtëpitë e pushimit të fëmijëve, punëtorëve dhe studentëve deri në privatizimin e tyre apo të shndërrimit në shoqëri të përbashkëta.

Neni 3

Ministria e Financave dhe e Ekonomisë të nxjerrë udhëzim për zbatimin e këtij ligji.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.607, datë 29.7.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.